



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU

(Prill 2020 - mars 2021)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

Shkurt 2020



Përmbajtja

Hyrje.....	3
1 Bilanci i energjisë elektrike 2020	4
2 Kostot me shumicë - blerjet e energjisë	5
2.1 Përshtatjet e të hyrave për vitin 2019	6
3 Kostot e bartshme.....	7
4 Kostot me pakicë të furnizuesit	7
5 Të hyrat e lejuara maksimale	9



Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht është duke kryer Përshtatjet e Rregullta Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të mbulohen nga Kompanitë e Rregulluara. Në këtë proces, ZRRE-ja do të bëjë propozimin fillestar për MAR-in e azhurnuar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Ky vlerësim fillestar bazohet në propozimet e dorëzuara nga kompanitë e rregulluara si dhe vendimet për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën rregullative 2018-2022.

Ky Raport Konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së për propozimin për të hyrat e lejuara maksimale (MAR) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) për vitin relevant tarifor 2020. Në vlerësimin e kostos së blerjes së energjisë me shumicë, ZRRE ka marrë parasysh kostot direkte të Furnizuesit ndaj BRE-ve, sipas rregullës për Skemën Mbështetëse, kostot për blerjen e energjisë nga gjeneratorët tjerë sipas kushteve kontraktuale dhe importet.

Palët të cilat dëshirojnë të paraqesin komentet e tyre eventuale rreth propozimeve të ZRRE-së, ftohen që të dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në postën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org, jo më vonë se **4 mars 2020**. Gjithashtu, komentet mund të dërgohen me postë në adresën:

*Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12, Prishtinë, 10000, Kosovë*

Dokumentet relevante

Aplikimi tarifor i FSHU për vitin 2020	http://www.ero-ks.org/2020/Tarifat/Aplikimi%20i%20FSHU-se%20per%20MAR-in%20e%20vitet%202020.pdf
Aplikimi tarifor i KOSTT për vitin 2020	http://www.ero-ks.org/2020/Tarifat/200121_KOSTT_Azhurnimet%20Vjetore%20te%20te%20hyrave%20maksimale%20te%20lejuara_2019-2020.pdf
Aplikimi tarifor i KEDS për vitin 2020	http://www.ero-ks.org/2020/Tarifat/Aplikimi%20i%20OSSH-se%20per%20MAR-in%20e%20vitet%202020.pdf



1 Bilanci i energjisë elektrike 2020

Në këtë shqyrtim tarifor ZRRE ka përdorur bilancin e aprovuar të energjisë elektrike, për të marrë parasysh konsumin e përditësuar dhe vlerësimin për dërrgullimin e konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 35kV. Ky bilanc duhet të reflektojë vetëm kostot e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kushte të shërbimit universal. Në këtë kuptim edhe volumet për blerjet e energjisë me shumicë për FSHU janë:

- Blerjet e energjisë nga KEK SH.A;
- Blerjet e energjisë nga gjeneratorët e kyçur në nivel të transmetimit;
- Blerjet e energjisë nga gjeneratorët e kyçur në nivel të shpërndarjes; dhe
- Importi.

Sasia e energjisë për eksport gjatë këtij parashikimi nuk është konsideruar si energji e FSHU-së, pasi që FSHU duhet të nominojë vetëm sasi të nevojshme për mbulimin e konsumit të konsumatorëve me shërbim universal. Kjo sasi e energjisë duhet të menaxhohet nga prodhuesi përkatës në pajtim me prioritetet e dispeçimit. Konsumi i konsumatorëve me shërbim universal nuk përfshinë:

- kategoritë e konsumatorëve të kyçur në nivel të transmetimit; dhe
- nga muaji prill 2020 konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 35kV të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligjin për Energji Elektrike.

Në tabelën në vijim janë dhënë burimet e furnizimit për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve të FSHU-së.

Tabela 1: Bilanci i energjisë elektrike për FSHU

Blerjet e energjisë	GWh
Sasitë e furnizuara nga KEK	3,496
Gjeneratorë tjerë në nivel të OST	201
Gjeneratorët në nivel të OSSh-së	259
Importi	156
Total sasitë e furnizuara	4,111
Konsumi sipas kategorive të konsumatorëve FSHU	
Konsumatorët 35 kV	18
Konsumatorët 10 kV	441
Konsumatorët 0.4 kV	3,651
Total konsumi i konsumatorëve të FSHU	4,111

Siç shihet nga tabela, sasia e energjisë që planifikohet të konsumohet nga konsumatorët me të drejtë të shërbimit universal është e barabartë me sasitë që duhet të mbulohen nga burimet e ndryshme të furnizimit.

Shënim: Sasia nevojshme për tu furnizuar nga Importi është kalkuluar si diferencë e sasisë totale ndaj burimeve tjera të furnizimit.



Mbulimi i humbjeve në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjësi e operatorëve të rrjeteve përkatëse dhe siç shihet ato nuk janë paraqitur në këtë tabelë. Trajtimi i tyre është bërë në Raportet Konsultative për MAR-et e OST/OT-së dhe OSSh-së.

2 Kostot me shumicë - blerjet e energjisë

Pas përcaktimit të sasive të nevojshme për furnizim me qëllim të mbulimit të kërkesave të konsumatorëve të FSHU-së, duhet të bëhet edhe kalkulimi i kostove për blerje të energjisë në tregun me shumicë. Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të sigurojë energji elektrike në mënyrë transparente, konkurruese dhe efikase. Furnizuesi me Shërbimit Universal duhet të demonstrojë se çmimet e parashikuara të energjisë elektrike që do të prokurohen janë të arsyeshme.

Gjatë procesit të negocimit të kontratave për blerje të energjisë së FSHU-së nga gjenerimi vendor, duhet pasur parasysh faktin se çmimet e parashikuara janë në përputhje me çmimet historike dhe ato të projektuara të tregut me shumicë të Kosovës.

Kostot e lejuara të energjisë me shumicë ($WHPC_t$) duhet të llogariten sipas formulës:

$$WHPC_t = (GENC_t + IMPC_t + IMBC_t * IMBF_t) * (1 + RETM_t)$$

Ku:

$GENC_t$ Kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendorë në vitin relevant t

$IMPC_t$ Kostot e lejuara të energjisë së importit në vitin relevant t

$IMBC_t$ Kostot neto të imbalancit në vitin relevant t

$IMBF_t$ Faktori ndarës i imbalancit në vitin relevant t

$RETM_t$ Marzha me pakicë në vitin relevant t

Përmbledhja e kostove me shumicë të parashikuara për vitin 2020 është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 2: Blerjet e energjisë

Kostot e blerjes së energjisë	GWh	€/MWh	€'000
Sasitë e furnizuara nga KEK	3,496	29.50	103,126
Gjeneratorë tjerë në nivel të OST-së	201	56.90	10,146
Gjeneratorë në nivel të OSSh-së	259	43.37	9,515
Importi	156	57.00	8,913
Kostot e jobalanceve		-	-
Faktori ndarës i jobalanceve		-	-
Total sasitë e furnizuara	4,111	32.05	131,699
Margjina me pakicë		3.00%	3,951
Total kostot e blerjes së Energjisë	4,111	33.74	135,650

Është e rëndësishme të theksohet, që FSHU është i obliguar sipas Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, përkatësisht neni 17 dhe Shtojca 3, që të sigurojë energji elektrike në mënyrë transparente,



konkurruese dhe efikase. Si rrjedhojë FSHU duhet të demonstrojë që çmimet e blerjes së energjisë duhet të jenë të arsyeshme dhe të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 17 të Rregullës për të hyrat e FSHU.

Në mungesë të këtyre dëshmive, ZRRE në vlerësimin preliminar ka parashikuar kostot e blerjes së energjisë me shumicë bazuar në çmimet aktuale të realizuara në vitin 2019, por gjatë procesit të konsultimit publik, palët duhet të respektojnë parimet e sipërpërmendura dhe të dëshmojnë se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore, rregullative dhe procedurale që kanë të bëjnë me blerjet e energjisë me shumicë.

2.1 Përshtatjet e të hyrave për vitin 2019

Për të bërë përshtatjet e vitit 2019, të cilat do të aplikohen gjatë përcaktimit të MAR-it të FSHU-së për vitin 2020, së pari duhet bërë vlerësimin e kostove aktuale të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e FSHU-së. Pas vlerësimit të këtyre kostove duhet të bëhet zbritja nga të hyrat që kanë rezultuar nga faturimi në vitin 2019 nga aplikimi i tarifave.

Ndryshimi në mes të të hyrave të vlerësuara nga ZRRE-ja për vitin 2019 dhe të hyrave të realizuara nga FSHU gjatë periudhës së njëjtë është llogaritur sipas formulës në vijim:

$$ADJ_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku janë:

AAC_{at-1} Kostot e lejuara aktuale të FSHU-së në vitin relevant t

ARR_{t-1} Të hyrat aktuale të rregulluara gjatë vitit relevant t-1

I_t Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra

Vlera e përshtatjeve për vitin 2019 pas indeksimit për inflacion rezulton të jetë -12.7 milion euro.

Tabela 3: Përshtatjet për vitin 2019

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	2019
Parametrat e indeksimit		
Norma e interesit I_t	%	6.85%
Kostot me pakice të furnizuesit		
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	6.1
$Zh\text{vlerësimi} - DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.1
Kostot e bartshme		
Kostot e OST	€m	27.5
Kostot e OSSh	€m	103.2
Fondi BRE		9.6
Kapitali punues (WCLCt)		



WCLC= (1 / 12) * It * (RETRt + WHPct + PSTCt - NTFRt)	€m	1.5
Kostot për blerjen e energjisë		
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	120.6
Taksa për licencë		
Taksa për licencë	€m	0.01
Borxhi i keq (BDTA)		
BDTA	%	4%
BDTA	€m	9.8
Përshtatjet		
Përshtatjet 2018		-32.4
Përshtatjet e të hyrave për FSHU		
MAR-i i Furnizuesit AAC _{at-1}	€m	246.0
Të hyrat aktuale nga faturimi ARR _{t-1}	€m	257.9
Përshtatja e të hyrave ADJ_t	€m	-12.7

Kjo vlerë e përshtatjeve prej -12.7 milion euro do të bartet gjatë përcaktimit të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2020.

Gjatë analizimit të blerjeve të energjisë me shumicë dhe faturimit të energjisë për konsumatorët me shërbim universal nga KESCO, ZRRE ka vërejtur një dallim në sasinë e energjisë së blerë me shumicë dhe sasisë së energjisë së faturuar për konsumatorët me shërbim universal. Ky dallim rrjedh nga mekanizimi balancues, dhe ato do të trajtohen pas rishikimit të mekanizmit balancues.

Rregulla për të hyrat e FSHU-së e definojnë qartë trajtimin e jobalanceve, mirëpo mekanizmi balancues nuk ka evidentuar tërheqjet e KESCO/FSHU nga sistemi dhe nuk ka faturim ndaj KESCO-së për këtë qëllim. Megjithatë, KESCO në aplikacionin e tij nuk ka prezantuar të dhënat lidhur me kostot e jobalanceve të vitit 2019 dhe dallimet që kanë rrjedhur nga tërheqjet në sistem nga mekanizmi balancues. Sidoqoftë, ZRRE ka aplikuar kostot/të hyrat e jobalanceve për vitin 2019 duke përfshirë korrigjimet për tremujorin e parë të vitit 2019 duke u bazuar në raportet për jobalancet nga KOSTT-i. Mirëpo, siç u theksua edhe më lartë, tërheqjet (kostot/të hyrat) e FSHU-së nga mekanizmi i jobalanceve do të trajtohen pas rishikimit të mekanizmit balancues.

3 Kostot e bartshme

Kostot e bartshme të FSHU-së janë ato që varen nga vlerësimet për MAR-et për kompanitë tjera të rregulluara. Këto janë kostot e bartshme nga KOSTT, KEDS (PSTCt), dhe ndonjë kosto tjetër që është jashtë kontrollit të FSHU-së. Kostot e bartshme për KOSTT, përfshirë edhe fondin për burimet e ripërtëritshme janë 36.9 milion euro, ndërsa kostot e bartshme për KEDS janë 94.6 milion euro.

4 Kostot me pakicë të furnizuesit

Kostot e lejuara me pakicë llogariten si shuma e kostove të lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (OPMct), zhvlerësimi (DEPct) dhe ato të licencës (LCICt). Kostot e propozuara me pakicë për FSHU për vitin 2020 kanë përdorur si bazë kostot e lejuara në vitin 2019 dhe të indeksuara për normën e



inflacionit me vlerë prej 1.19%¹. Vlera e kostove me pakicë për FSHU për vitin 2020 është paraparë të jetë 6.2 milion euro. Komponentët tjerë të kostove me pakicë, siç janë: marzha me pakicë, borxhi i keq dhe kapitali punues janë kalkuluar në bazë të formulave të përcaktuara në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së.

¹ Burimi: Eurostat, <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do> (vizituar më 27.01.2020)



5 Të hyrat e lejuara maksimale

MAR i propozuar për FSHU për vitin 2020 është 273.3 milion euro, e cila paraqet shumën që do të mbulohet nga tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë. Detajet e kalkulimeve për MAR-in e propozuar janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 4 - MAR i propozuar për vitin 2020

MAR-i i Furnizuesit me Shërbim Universal	Njësia	2020
Parametrat e indeksimit		
Norma e interesit It	%	6.85%
Kostot me pakice te furnizuesit		
$OPEX - OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	6.2 ⁱ
$Zhvierësimi - DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.1
Kostot e bartshme		
Kostot e OST	€m	21.1
Kostot e OSSh	€m	94.6
Kostot për fondin e BRE	€m	15.8
Kapitali punues (WCLCt)		
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFRT_t)$	€m	1.6
Kostot për blerjen e energjisë		
Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	€m	135.7
Taksa për licencë		
Taksa për licencë	€m	0.03
Borxhi i keq (BDTA)		
BDTA	%	4%
BDTA	€m	11.0
Përshtatjet e të hyrave për FSHU		
Përshtatjet e vitit 2019	€m	-12.7
Të hyrat e lejuara maksimale	€m	273.3

ⁱ Në kostot operative janë të përfshira edhe kostot e sigurimit shëndetësor sipas kërkesës së FSHU-së